



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 169 Prot.

Tiranë, më datë 24.08 2023

VENDIM

Nr. 466, datë 24.08.2023

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 24.08.2023:

VENDOSI:

1. Miratimin e relacionit për gjetjet arkeologjike rastësore në kuadër të projektit “2 komplekse turistike me 3 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë në Voskopojë”, Brenda Kufirit të Ansambllit Historik Urban Voskopje, me zhvillues “Selmani Construction” sh.p.k, hartuar nga Drejtoria e Shërbimit Arkeologjik në IKTK;
2. Të vijohet nga subjekti i licencuar në arkeologji me sqarimin e strukturave të mureve të zbuluara, dokumentimin dhe përcaktimin e vlerave të tyre nga pikëpamja arkeologjike;
3. Raporti me rezultatet e dokumentimit arkeologjik të paraqitet për shqyrtim dhe vendimmarrje pranë KKTKM-së;
4. Pjesa tjetër e punimeve në zonën ku nuk janë evidentuar gjetje arkeologjike të vijojë nën monitorimin arkeologjik të subjektit të licencuar, sipas akt-marrëveshjes 3 palëshe të lidhur më parë për këtë projekt;
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
6. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi;
7. Ndaj vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Elva MARGARITI

SEKRETAR

Klesta QIRICI

Klesta  
Qirici

Digitally signed by  
Klesta Qirici  
Date: 2023.08.25  
13:33:51 +02'00'

Elva  
Margariti

Digitally signed by Elva  
Margariti  
Date: 2023.08.25  
13:41:47 +02'00'